



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:043219
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05770653

Ac.nr.420/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores A.A. nga Kamenica, të cilën e përfaqëson Y.H., avokat në Gjilan, sipas autorizimit, kundër debitorit: Y.A. nga fshati Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson K.S., avokate në Prishtinë, sipas autorizimit, lidhur me çështjen përmbarimore, për besimin e fëmijës, duke vendosur sipas ankesës së debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, CP.nr.77/2023, datë 13.11.2023, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Y.A. nga fshati Komuna e Vitisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan- Dega në Viti, CP.nr.77/2023, i datës 13.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar CP.nr.77/2023, të datës 13.11.2023, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Y.A. nga fshati Komuna e Vitisë, i ushtruar kundër Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.77/2023, i nxjerr me datë 02.05.2023, për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës në Thonon-Les-Bains të Francës, me nr. të lëndës 17/02331 dhe nr. të Portalis DB2S-W-B7B-D2R, i plotfuqishëm me datë 12.02.2021, ndërsa i njohur dhe i pranuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan CN.nr.174/2022, me datë 11.10.2022, me të cilin debitori obligohet që brenda afatit prej 8 ditësh t`ia dorëzoj kreditores fëmijën e mitur D.A., i lindur me datë 25.01.2014 në Metz - Tessy të Francës, ndërsa fëmija gjendet në Sllatinë të Epërme me babain e vetë, debitorin Y.A.

Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti CP.nr.77/2023, i nxjerr me datë 02.05.2023, mbetet në fuqi.

Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës, të krijuara deri më tani.

Kundër këtij aktvendimi e autorizuar e debitorit brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e debitorit, të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ose aktvendimi të anulohet dhe lënda t`i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i kreditores i ka kundërshtuar në tërësi të pabazuara pretendimet ankimore të debitorit, me propozim që ankesa të refuzohet ndërsa aktvendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja, me datë 15.02.2023 në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Viti, ka paraqitur propozim për përmbarim në bazë të aktgjykimit të Gjykatës në Thonon-Les-Bains të Francës, me nr. të lëndës 17/02331 dhe nr. të Portalis DB2S-W-B7B-D2Ri, i plotfuqishëm me datë 12.02.2021 si dhe i njohur dhe i pranuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan CN.nr.174/2022, me datë 11.10.2022. Propozimi në fjalë, është lejuar me aktvendimin e gjykatës të evidencuar me shenjën E.nr.77/23 datë 02.05.2023.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, debitori përmes përfaqësueses së autorizuar ka paraqitur prapësim me datën 04.10.2023. Sipas parashtrimeve në prapësim çështja e besimit të fëmijës është ende e papërfunduar në gjykatë, përderisa është në zhvillim procedura kontestimore sipas lëndës C.nr. 331/2023, ku objekti i çështjes është ndryshimi i aktgjykimit lidhur me

kujdestarinë e fëmijës. Nga arsyet e parashtruara ka propozuar pezullimin e aktvendimit për lejimin e përmbarimit, deri në përfundimin e kontestit gjyqësor sipas padisë C.nr.331/2023

Me përgjigje në prapësim të datës 01.11.2023, i autorizuari i kreditores ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe lihet në fuqi aktvendimi CP.nr. 77/23 i datës 02.05.2023, mbi lejimin e përmbarimit të propozuar, pasi përmbarimi është lejuar në bazë të titullit përmbarimor-aktgjykimit të plotfuqishëm dhe asnjë procedurë tjetër, nuk mund të ketë ndikim për ndalimin ekzekutimit të aktgjykimit të plotfuqishëm.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimi, me aktvendimin e atakuar CP.nr.77/2023, të datës 13.11.2023, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata ka parashtruar se nga shkresat e lëndës ka rezultuar se kreditorja ka iniciuar procedurën e përmbarimit mbi bazën e aktgjykimit të Gjykatës në Thonon-Les-Bains të Francës, me nr. të lëndës 17/02331 dhe nr. të Portalis DB2S-W-B7B-D2Ri, i plotfuqishëm me datë 12.02.2021. I njëjti aktgjykim është njohur dhe pranuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan CN.nr.174/2022, me datë 11.10.2022, i plotfuqishëm me datë 20.10.2022. Nga kjo gjendje faktike, gjykata prapësimin e debitorit e vlerësoi si të pabazuar për faktin se dokumenti në bazë të të cilit është marrë Aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit CP.nr.77/2023, i datës 02.05.2023, ka titull ekzekutiv dhe tipare të përmbarueshmërisë, gjersa debitori me asnjë provë relevante të paraparë me nenin 71, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP-së), nuk e ka bazuar dhe arsyetuar prapësimin e tij, prandaj gjykata vendosi që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi aktvendimin CP.nr.77/2023, të datës 02.05.2023.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 13 paragraf 4 dhe 71 të LPP-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka vlerësuar provat në shkresat e lëndës, të ofruara nga palët ndërgjyqëse, mbi bazën e të cilave ka ardhur në përfundim se prapësimi duhet të refuzohet si i pabazuar, meqë në prapësim nuk është paraqitur asnjë nga shkaqet të cilat janë parapara në nenin 71 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), që do të pengonin përmbarimin e lejuar.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktgjykimi i Gjykatës në Thonon-Les-Bains të Francës, me nr. të lëndës 17/02331 dhe nr. të Portalis DB2S-W-B7B-D2Ri, i plotfuqishëm me datë 12.02.2021 dhe i ekzekutueshëm si dhe i njohur dhe i pranuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan CN.nr.174/2022, me datë 11.10.2022, në këtë rast është dokument përmbarues, në kuptim të nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, ku përcaktohet se: “dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet

ankimore të debitorit se gjykata ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me rastin e refuzimit të prapësimit nuk qëndrojnë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje, e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Në procedurën përmbartimore behet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin, ashtu siç ka vepruar në rastin konkret edhe gjykata e shkallës së parë me lejimin e përmbartimit në bazë të dokumentit përmbartues, të përcaktuar si në dispozitën e nenit 22 par 1, pika 1.1 të LPP.

Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se: “Baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitorin me anë të prapësimit nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilën do të argumentonte ndonjëherë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.420/24, me datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Hunaida Pasuli